



Kur vjen puna për sekrete, Apple po dyfishon masat po aq sa po i pjeston me zero. iPhone 5 është një telefon që ka shumë gjera për herë të parë – ekran me të madh, lidhje Lightning, teknologji prekëje in-cell, përfshi inovacione të tjera, por gjithashtu është i pari telefon që mban emrin iPhone, specifikat e të cilit dihenin thuajse totalisht përpara prezantimit.

Si fillim u mesua rreth ekranit 4 polësh. Kjo u bë e mundur falë The Wall Street Journal më 16 Maj, u konfirmuar nga Reuters më 17 Maj dhe u ripërmend nga Bloomberg më 18 Maj. Më 19 Maj, edhe sikur ndonjëra nga gazetat apo faqet e mirnjohura të kishin ndonjë njeriun e tyre përgjate zinxhirit të dorezimit të produktit, thjeshtë nuk ja vlen të shpenzonin miqesitë për t'u siguruar rreth madhësisë së ekranit.

ASHTU SI ZBULOHEN SEKRETET E APPLE, EKRANI I IPHONE 5 ISHTË SEKRETI ME KEQ I MBAJTUR NË HISTORINË E KOMPANISË

Por nuk ishte vetëm kaq. U mesua çdo gjë rreth rezolucionit, raportit të shikimit, dhe teknologjive të vecante të prekjes rreth këtij ekrani, përpara se administratori i Sharp të pranonte drejtpërdrejtë që ishte kompania e tij që po furnizonte Apple me ekrane.

Konektori i rizidizenuar, ndryshimi i pozicionit të xhekut të kufjeve, kapaku i prapem alumin dhe paneli ballor i iPhone 5 filluan të dilnin në thuajse të gjitha faqet me përmbajtje teknologjike në javët e mëpasshme, duke arritur kulmin në disa modele totalisht të kompletuara (si në faqen 9to5Mac). Prodhuesit e kapakeve dhe kellefeve ishin aq të sigurt sa që po tregonin kapaket e iPhone-it të ri përpara se Apple të deklaronte që do mbante një shfaqje në shtator.

Kur Apple më në fund dergoi ftesat për eventin e saj më 12 Shtator (datë që u zbulua serish përpara), hoqi çdo dyshim të vogël rreth emrit të ri të iPhone-it të saj duke i dhënë hije datës 12 me një 5.

Paaftesia e Apple per te mbajtur iPhone 5 sa me sekrete, eshte e turpshme per administratorin e saj, i cili premtoi nje permiresim ne sigurine dhe sekretin e produkteve te firmes, por gjithashtu nuk ishte as e paparashikueshme. Edhe pse Tim Cook ka mbajtur freret nga lart po aq te terhequr sa dhe Steve Jobs, kontrolli i tij mbi partneret konsiderohet si nje problem me vete.

Zinxhiri i furnizimit te Apple sa ka ardhur dhe eshte ndryshkur. Ne kohen kur kompania mbeshtetej tek Samsung-u per pjesen me te madhe te komponenteve te brendshem te iPhone, tek LG-ja per ekranin, kete vit iu desh te kontraktonte Sharp-in, LG Display dhe Japan Display per ekranin e saj te ri 4 poles. Me rritjen e mundesise se rrjedhjeve te informacionit, ashtu eshte rritur dhe numri i punetoreve qe kontribuan ne prodhimin e iPhone. Per nje punetor ne linjen e assemblimit te produktit nga nje nga nenkontraktoret e Apple, rrjedhja e informacionit do t'i jepte mundesine te fitonte me teper se sa kerkesa e tij per pune me ore shtese per te mbajtur gjalle familjen.

Ndaj po, zinxhiri i furnizimit eshte bere i vetedijshem dhe ka hapur gropeza ne mistiken e famshme te Apple. Dhe cfare pastaj? Atehere, si fillim Apple humb impaktin e evenimentit te saj qe zakonisht paraqiste aparate totalisht te panjohur. Askush nuk u habit ka kapaku i aluminit dhe hollesia sepse te gjitha e kishin pare (e shume te tjere madje e kishin prekur). Nuk pati asnje frymemarrje te thelle kur Apple prezantoi LTE, ose kur prezantoi Earpod-et e rinj, apo lidhjen e re Lightning.

Sidoqofte, edhe pse kjo gje i heq Apple-it pak ndricim nga evenimenti i saj me i fundit, efekti final i te gjitha ketyre rrjedhjeve mund te jete minimal ne rradhet e konsumatorit. Fundja, pjesa me e madhe e bleresve te iPhone nuk do te kalojne tere ditën ne kerkimin e thashethemeve neper internet. Kercenimi me i madh qe Apple do ti duhet te kaperceje eshte se konkurrentet e tij po mesojne rreth sekreteve te Apple sa vjen e me shpejt cdo vit qe kalon. Kjo i jep kompanive si Nokia, mundesine per te provuar dhe vjedhur driten e Apple duke paraqitur funksionalitete ne telefonat e tyre perpara saj, nderkohe qe krijuesit e kloneve jane bere aq te afte saqe njeri prej tyre ka tentuar te patenteje dizenjon e iPhone 5 per Kinen.

SAMSUNG-U DUHET TE NDJEHET KRENAR SOT

Kundershtari me i drejtperdrejte i Apple ne teknologjine mobile, duhet te ndjehet i vetekenaqur sot . Mamuthi koreant arriti te mbante sekretin e Galaxy S III deri ne momentin e prezantimit te tij, me disa aparate te vendosur ne menyre strategjike per te dizinformuar dhe turbulluar ujrat e gazetave dhe faqeve informuese ne menyre qe prezantimi te ishte me te vertete nje surprize. E njejta gje vlen dhe per Kameran Galaxy te nxjerre ne treg 2 jave me pare: ishte nje aparat mjaft terheqes i mbajtur i fshehur deri ne momentin final.

Samsung-u vazhdon te jete kontraktori kryesor i procesoreve te serise A brenda iPhone-ve, iPad-eve dhe iPod-eve, dhe eshte fale kompanise Koreane qe procesori A6 per iPhone 5 mbeti nje sekret deri ne prezantimin zyrtar. Te pakten, kur behet fjale per liri veprimi, mund te themi qe Samsung-u po fiton aty ku Apple po deshton.

Kushdo qofte arsyeja, dalja e sekretit eshte dicka qe kompania nuk mund te toleroje. Produktet e saj qe kane thyer rekorde shitjeje jane ndertuar ne baze te cilesise dhe thjeshtesise se perdorimit, por gjithashtu mbeshteten edhe ne njefare miti, deshire nga e panjohura qe

kompania Apple ka projektuar. Pagoditshmeria e cmimit te stoqeve te Apple, papenetrueshmeria e planeve te saj rreth produkteve te reja, ftohtesia e ish administratorit te saj — keto faktore qe ne dukje konsiderohn te huaj, kane kontribuar te gjitha ne imazhin e nje kompanie teknologjike qe ne nje fare menyre eshte e ndare nga industrite e tjera dhe e jashtezakonshme. Edhe pse iPhone 5 konsiderohet i shndritshem dhe i deshirueshem, nuk eshte me nje surprize dhe tregon dobesimin e asaj korace qe Apple kishte krijuar deri tani. Tani eshte ne dore te Tim cook te mbaje premtimin e tij./teknologji.net/